



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna e Klinës  
Kryetari i Komunës  
01Nr. 06-2628/2023  
Klinë, datë 07/08/2023

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 4 dhe 10 të Ligjit, Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra më Ligjin, Nr. 03/L-205, botuar në Gazetën Zyrtare numër 91/2010, nenin dhe 22 dhe 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nr.05/L-031 publikuar në gazetën Zyrtare nr.8/2016, dispozitat e nenit 91 të statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe vendimin e Kuvendit të Komunës, nr.01-06-7065/2022 të miratuar më datën 25.02.2022 për shpalljen e zonës me interes publik të parcelës, nr. 109-4 ZK Çabiq Komuna Klinë, më qellim të shpronësimit për realizimin e projektit ndërtimi i rezervuarit për furnizim me ujë të disa fshatrave të Komunës së Klinës, kryetari i komunës së Klinës, mori:

**V E N D I M - P R E L I M I N A R**

- MIRATOHET**, shpronësimi i parcelës kadastrale, nr.P-71010080-00109-4 ZK Çabiq Komuna e Klinës, më sipërfaqe prej 1527 m<sup>2</sup>, e evidentuar në pronësi të Zelfije (Milazim) Bashotaj nga fshati Caravik Komuna e Klinës, me kërkesën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në të cilën parcele sipas projektit të Komunës së Klinës është parapare ndërtimi i rezervuarit akumulues për furnizim me ujë të disa fshatrave të Komunës së Klinës.
- Vërtetohet së qëllimi është i ligjshëm publik dhe i domosdoshëm i sigurimit të tokës për ndërtimin rezervuarit për furnizim me ujë të disa fshatrave të Komunës së Klinës sipas projektit, ndërsa shpronësimi është në funksion të arritjes së këtij qëllimi.
- Obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi që në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, t'ia dërgoj vendimin preliminar personit të përmendur si në pikën 1 të këtij vendimi brenda pesë (5) ditëve të punës.
- Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të vendimit preliminar, drejtoritë përgjegjëse bëjnë shpalljen e këtij vendimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
- Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi si dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente.
- Pjese përbërëse e këtij vendimi është lista me përshkrim detaj të parcelës e cila shpronësohet.

- Kundër këtij vendimi apo cilëso pjesë të tij brenda 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të tij ka të drejtë të paraqesë ankese në Gjykatën Themelore në Peje Dega në Klinë, çdo person i cili është pronar ose zotëruar i interesit në pronën e prekur nga vendimi, nëse ka arsye bindëse për të besuar së vendimi preliminar është në kundërshtim me një ose më shumë kushte të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra më Ligjin, nr.03/L-025 të datës 28.10.2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.91).

- Të njoftohen:
- Pronari/et- zotëruar/it e interesit;
  - Drejtoritë komunale;
  - Zyra e informimit, si dhe;
  - Arkivi.

Kryetari,  
Zenun Elezaj



**A r s y e t i m**

Kryetari i komunës së Klinës më kërkesën, nr.01-464-18162/2023 të datës 01.06.2023 të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente, më qellim të arritjes së interesit të përgjithshëm publik ka iniciuar procedurat e shpronësimit të pronës së paluajtshme të evidentuar në emër të pronares Zelfije (Milazim) Bashotaj, parcela më nr. P-71010080-00109-4 ZK Çabiq Komuna e Klinës, më sipërfaqe prej 1527 m<sup>2</sup> are e klasës së pestë (5).

Paraprakisht nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës është marre vendim për shpalljen e parcelës së përmendur si në dispozitiv të vendimit prone me interes të veçante publik për ndërtimin e rezervuarit për furnizim me ujë të disa fshatrave të Komunës së Klinës, pas përfundimit të procedurave të shpronësimit.

Shpronësimi i parcelës së përmendur behet për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik përkatësisht realizimit të projektit- ndërtimit të rezervuarit akumulues për furnizim me ujë të pijes së këtyre fshatrave të Komunës së Klinës, si: Caravik, Zabergje, Gllarevë, Perqeve, Doberdol dhe Gjurgjuvik i Madh.

Ky qellim nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit të kësaj parcele kadastrale dhe përfitim publik nga shpronësimi është më i madh së interesat të cilat ndikohen negativisht nga shpronësimi.

Lidhur me procedurën e shpronësimit është publikuar njoftimi për dëgjim publik, njoftuar pronari dhe është përgatitur i ter dokumentacioni i nevojshëm nga ana e drejtorive përgjegjëse si dhe është vërtetuar së qëllimi është i ligjshëm publik dhe i domosdoshëm për realizimin e projektit ndërtimin e rezervuarit për furnizim me ujë të pijes në interes të përgjithshëm publik.

**Lista me të dhënat e parcelës**

Pronari	Nr. i parcelës	Kultura	Klasa	Sipërfaqja e përgjithshme	Zona kadastrale	Sipërfaqja për shpronësim	Vërejtje
Zelfije (Milazim) Bashota	109 - 4	Arë	V	0.15.27 Ha	Çabiq	0.15.27 Ha	/

Shënim: Të dhënat janë sipas çertifikatës së pronësisë

Gjeodete:  
Greta Skeli



Drejtori:  
Besnik Marku